



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**VENDIM**

**Nr. 100/2018**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE  
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR  
TË KUALIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Lidhja nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.


II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 4.10.2018



**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR  
TË KUALIFIKIMIT**

| <b>FUNKSIONI ORGANIK</b>   | <b>Klasifikimi i pagës</b>                      | <b>Numri</b> |
|--|---|--------------|
| <b>I. KRYETAR</b>  | G3*   | (2)          |
| Sekretar   | Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit** | 1            |
| <b>II. KOMISIONERËT</b>  | G3*   | (11)         |
| <b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>  |   | (24)         |
| Këshilltarë juristë  | 80% e pagës G3*                                 | 12           |
| Këshilltarë ekonomistë   | 80% e pagës G3*                                 | 12           |
| <b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>   | I-a   | 1            |
| <b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE<br/>DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b> |   | (16)         |
| Drejtor  | II-b  | 1            |
| Specialist sekretarie gjyqësore  | III-b   | 6            |
| Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve  | IV-a  | 2            |
| Përkthyes  | II-b  | 5            |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë  | III-a   | 1            |
| Specialist pritje me popullin  | IV-a  | 1            |
| <b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE<br/>MBËSHTETËSE</b>                            |   | (10)         |
| Drejtor  | II-b  | 1            |
| Specialist financë/buxhet  | III-b   | 1            |
| Specialist i burimeve njerëzore  | III-b   | 1            |
| Specialist IT ***  | III-b   | 1            |
| Specialist protokoll/arkivë ****   | IV-a  | 2            |
| Magaznier  | VII   | 1            |
| Punonjës pastrimi  | III   | 2            |
| Shofer/ Korrier  | VI  | 1            |
| <b>Gjithsej</b>  |   | <b>64</b>    |

*Shënim:*

\*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

\*\*Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\*\* Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

**Strukturë organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

